



KOSTOJA E BIXHOZIT: SHPENZIMET NË LOJËRA TË FATIT DHE PASOJAT E VARËSISË

HYRJE

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më 21 shkurt 2023, me përfaqësues Fatmir Besimin si Ministër i Financave, Filip Nikoloski si zëvendësministër i Financave dhe Magdalena Simonovska këshilltare shtetërore në ministrinë e Financave bënë Propozim Ligj për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit për Lojërat e Fatit dhe Lojërat Argëtuese.

Ligji është dërguar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë më 27 shkurt 2023 dhe është në procedurë parlamentare, ku pritet të votohet së shpejti pasi i njejtë është ligj me flamur evropian. Zakonisht flamuri evropian i vendoset ligjeve që janë kusht për anëtarim në Bashkimin Evropian ose ligjeve që synojnë harmonizimin e legjislacionit vendor me atë të Bashkimit Evropian. Në rastin në fjalë, pra lojërat e fatit, nuk ekziston ndonjë rregullore specifike sektoriale në nivel të BE-së. Madje, në disa raste, shërbimet e lojërave të fatit përjashtohen në mënyrë eksplicite nga fushëveprimtaria e ligjit të BE-së. Prandaj jo rastësisht kjo qasje sëbashku me përmbajtjen e Propozim-ndryshimeve shkaktuan debat dhe polemika të konsiderueshme në shoqëri.

Ky raport përfshinë analiza të dimensioneve të ndryshme që lidhen me lojërat e fatit me qëllim të informimit të debatit publik me gjendjen reale në mënyrë që debati të zhvillohet mbi fakte dhe argumente, dhe jo mbi emocione dhe spekulime. Fillimisht, raporti bën përmbledhjen e ndryshimeve të propozuara ligjore dhe analizon efektin potencial të cilin këto ndryshime mund ta kenë në industrinë e lojërave të fatit dhe në shoqëri. Për të marrë një perspektivë më të thellë mbi ndryshimet që priten të ndodhin, kemi zhvilluar intervistë gjysmë të strukturuar me dy përfaqësues të Lëvizjes Antibixhoz. Po ashtu, raporti bën edhe një shtjellim të problemeve kyçe në industrinë e lojërave të fatit duke u fokusuar në pasojat sociale dhe psikologjike të varshmërisë nga lojërat e fatit. Për të analizuar më mirë këtë dimenzion, kemi kërkuar edhe opinionin e një sociologu nga bota akademike. Në këtë raport ne po ashtu paraqesim për herë të parë një matje më transparente dhe kuantitative të të hyrave të industrisë së lojërave të fatit të cilat mund të merren si proksi i shpenzimeve që qytetarët i bëjnë në lojëra të fatit. Për ta arritur këtë qëllim, ne kemi marrë raportet financiare nga Regjistri Qendror i Maqedonisë dhe të dhënat janë të dorës së parë. Për më shumë, kemi bërë analizë edhe të profitabilitetit të kompanive më të mëdha dhe krahasime me Llotarinë shtetërore dhe kompani në vende tjera. Në fund, raporti përmban rekomandime dhe qëndrimet e Institutit IDEA se si duhet të rregullohet çështja e lojërave të fatit në Maqedoninë e Veriut.

Korniza ligjore e lojërave të fatit dhe lojërave argëtuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Ligji për lojërat e fatit për herë të parë pas pavarësisë së Republikës së Maqedonisë, u miratua nga ana e kuvendit të Republikës së Maqedonisë në seancën e mbajtur më 27 shkurt 1997. Kurse legalizimi i lojërave të fatit për herë të parë ndodhi qysh në vitin 1987 kur Republika e Maqedonisë së Veriut ishte pjesë e federatës së ish-Jugosllavisë: kazinoja e parë është hapur në Hotelin “Jugo” me emrin Apolonija në qytetin e Gjevgjelisë.

Industria e lojërave të fatit dhe lojërave argëtuese sipas ligjit në fuqi është nën kompetencën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila nëpërmjet Ministrisë së Financave lëshon licenca për organizatorët e lojërave të fatit dhe të njëjtët i kontrollon nëpërmjet Drejtorisë së të Hyrave Publike. Sipas ligjit në fuqi, lojërat e fatit mund të jenë të përgjithshme, të veçanta dhe lojëra të fatit nëpërmjet internetit. Lojërat e përgjithshme të fatit janë:

Tabela 1

Lojërat e përgjithshme të fatit	Lojërat e veçanta të fatit
Lojërat e fatit të Llotarisë	Lojërat e fatit në Kazino
Lojërat elektronike të fatit	Lojërat e fatit në bastore, dhe
Lojërat shpërblyese	Lojërat e fatit në klube me autmatë.
Lojërat interaktive të fatit	

Kurse lojëra të fatit nëpërmjet internetit janë **lojërat e veçanta dhe të përgjithshme të fatit**, si dhe llojet tjera të lojërave të fatit në të cilat pjesëmarrësi mund të marrë pjesë nëpërmjet rrjetit global të internetit.

Kush i organizon lojërat e fatit?

Neni 7 i ligjit për lojërat e fatit dhe lojërave argëtuese, thotë që “Organizimi i lojërave të fatit dhe lojërave argëtuese të percaktuara me këtë ligj është e drejtë e Republikës së Maqedonisë, nese me ligj nuk është rregulluar ndryshe.”

Lojërat e fatit të llotarisë dhe lojërat elektronike të fatit, përveç tombolës së tipit të mbyllur, Republika e Maqedonisë së Veriut në mënyrë të pavarur i organizon me themelimin e shoqërisë tregtare për organizimin e lojërave të fatit, në të cilën shteti është bashkëpronar ose aksionar me së paku 51% të kapitalit. Të drejtën për organizimin e lojërave tjera të fatit dhe lojërave argëtuese të percaktuara me këtë ligj, duke e përfshirë edhe tombolën e tipit të mbyllur, qeveria e bart me lëshimin e licencës, përkatësisht leje shoqërive tregtare, apo tregtarit individual, që i plotësojnë kushtet e percaktuara me këtë ligj. Lojërat argëtuese, lojërat shpërblyese dhe lojërat interaktive të fatit, organizohen në baze të lejes.

Licenca

Licenca është leja e lëshuar nga ana e Republikës së Maqedonisë së Veriut për shoqëritë tregtare e cila përmban të drejtat dhe obligimet e organizimit të lojërave të fatit. Licenca lëshohet për periudhë kohore që për çdo lojë të caktuar të fatit është percaktuar me ligj. Leja përmban të dhëna për organizuesin e lojës argëtuese, lojës shpërblyese përkatësisht lojës interaktive të fatit. Leja përmban llojin e lojës së fatit dhe kohëzgjatjen e lejes. Gjithashtu percaktohet edhe vendi ku do të organizohen lojërat e fatit si dhe shumën e kompensimit për lejen e marrë. Kompensimi për licencë paguhet ashtu që 50% e kompensimit paguhet gjatë lëshimit të licences, ndërsa pjesa tjetër prej 50% në këste të barabarta vjetore deri sa zgjat licenca.

Shoqëria tregtare së cilës i është lëshuar licencë për organizimin e lojërave të fatit detyrohet që në afat prej gjashtë muajsh pas mbarimit të vitit financiar, të dorëzojë raport të revizorit në Ministrinë e Financave, për revizionin e kryer nga ana e revizorit të autorizuar.

Kohëzgjatja e licencës varet nga lloji i lojës së fatit, si vijon:

Tabela 2

Licenca	Kohëzgjatja
Licenca për lojërat e fatit në kazino	6 vite
Licenca për tombolë të tipit të mbyllur	4 vite
Licenca për bastore sportive	3 vite
Licenca për lojërat e fatit në klubet me automatë	6 vite
Licenca për lojërat e fatit në internet	4 vite
Licenca për lojërat e fatit interaktive	1 vit
Licenca për lojërat shpërblyese	1 vit
Licenca për lojërat argëtuese	10 vite

Licenca mund t'i hiqet organizuesit të lojërave të fatit nëse konstatohet se nuk ka filluar organizimin e lojërave të fatit në afatet e përcaktuara, nuk i plotëson kushtet hapësinore dhe kushtet teknike-teknologjike, nëse shkelë rregullat e lojës së fatit, nuk i paguan regullisht kompensimet dhe taksat e posaçme të përcaktuara me ligj, nëse në mënyrë të pasaktë e paraqet qarkullimin e realizuar, nëse nuk vepron në pajtim me licencën, nëse nuk deponon depozitë ose nuk siguron garanci bankare, etj.

Shqyrtim i Propozim-Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Lojërat e Fatit dhe për Lojërat Argëtuese

Propozues i këtij Propozim-ligji është Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më 21 shkurt 2023, me përfaqësues Fatmir Besimin si Ministër i Financave, Filip Nikoloski si Zëvendësministër i Financave dhe Magdalena Simonovska Këshilltare Shtetërore në Ministrinë e Financave. Në këtë Propozim-ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Lojërat e Fatit dhe Lojërat Argëtuese parashihen disa ndërhyrje në ligjin aktual, ndërsa ne do të veçojmë për shqyrtim disa nga më të rëndësishmet që konsiderohen si zgjidhje themelore, të propozim ligjit, e të cilat do të ndikojnë më së shumti në industrinë e lojërave të fatit.

1. Do ti jipet e drejta Drejtorisë së të Hyrave Publike që të kërkojë nga Ministria e Financave që ta ndëpres organizimin e lojërave të fatit në shoqërinë aksionare që organizon lojëra të fatit kur has në parregullsi dhe shkelje të ligjit, meqenëse me ligjin aktual, këtë të drejtë Drejtoria e Të Hyrave Publike nuk e ka pasur.
2. Do të vlerësohet reputacioni i bashkëpronarëve apo bashkëpronarit të ri që i bashkangjitet shoqërisë aksionare. Reputacioni paraqet ndershmëri, kompetencë, diligençë dhe përvetësim të integritetit personal të cilat ofrojnë siguri se personi nuk do të ndikojë në drejtim të rrezikimit dhe dëmtimit të reputacionit dhe besimit të publikut në shoqërinë për organizimin e lojërave të fatit..
3. Do të përkufizohet distanca prej 500 metrave midis objekteve afariste që organizojnë lojëra të fatit dhe shkollave fillore dhe të mesme, në mënyrë që fëmijët të jenë gjoja të mbrojtur nga veset e këqija dhe konsiderohen minorent që të hyjnë në mardhënie obligative.
4. Do të sigurohet sistem informativ mbikëqyrës i cili do të lidhet drejtpërdrejtë me sistemin informativ të Drejtorisë së të Hyrave Publike, mekanizëm i cili me ligjin aktual ka ekzistuar vetëm për lojërat e fatit të veçanta, kurse tani do të implementohet edhe për organizatorët e lojërave të fatit elektronike dhe të internetit.
5. Do të rritet kompensimi mujor si dhe vlera e lëshimit të licencave.
6. Do të kufizohet numri i hapësirave afariste me klub me automatë me një licencë të lëshuar si dhe vendosja e kompensimit për çdo pikë pagese në bastore dhe për çdo hapsirë afariste
7. Sipas rregullativës aktuale, organizatorët e lojërave të veçanta të fatit, paguajnë detyrim të veçantë prej 20%, me të cilin paguhet diferenca ndërmjet pagimit dhe pagesës në nivel mujor, përkatësisht nëse në muajin e caktuar ka humbje, organizatori nuk do të paguajë detyrim të veçantë. Propozohet mënyrë e re e pagesës së detyrimit mujor, përkatësisht do të paguhet kompensim fisk ose për 20% në varësi të asaj se cila vlerë do të jetë më e lartë, pasi që qeveria dyshon se ka fshehje të të dhënave në sistemin informativ mbikëqyrës nga organizator të caktuar, duke shmangur kështu pagesën e detyrimit të veçantë ose duke paguar në vlerë më të vogël se ajo realja.

Licenca

Sa i përket licencave, risi paraqitet në procedurat e lëshimit të licencave për organizimin e lojërave të fatit ku propozohet që të vlerësohet edhe **reputacioni** i personave të cilët janë themelues të kompanive që aplikojnë për licencë. Reputacioni paraqet ndershmëri, kompetencë, diligençë dhe përvetësim të integritetit personal të cilat ofrojnë siguri se personi nuk do të

ndikojë në drejtim të rrezikimit dhe dëmtimit të reputacionit dhe besimit të publikut në shoqërinë për organizimin e lojërave të fatit.

Gjithashtu në nenin 4 të propozim ligjit përcaktohet se një shoqëri tregtare që organizon lojëra të fatit mund të organizojë vetëm një lloj lojërash të veçanta të fatit në bazë të një **licence** dhe kapitali bazë i shoqërisë që ka licencë për organizimin e lojërave të fatit nuk mund të jetë bazë për marrjen e licencës së re për organizimin e një loje tjetër të fatit siç ka qenë deri tani me ligjin aktual.

Tek pjesa e revokimit të licencës, propozohet gjithashtu që: "Shoqëria tregtare, të cilës i është revokuar licenca për organizimin e lojës përkatëse të fatit, nuk mund të parashtrojë kërkesë për licencë të re në periudhe trevjeçare nga dita e revokimit të licencës nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut."

Gjithashtu, me projektligjin e ri, do të rritet dhe vlera e pagesës për lëshimin e licencës. Për licencën për bastore çmimi rritet nga **105.000 euro në 200.000 euro**, si dhe kufizohet numri i pikave të pagesës në 25 për një licencë të lëshuar, me ç'rast për hapjen e çdo pikë të pagesës do të paguajë kompensim në vlerë prej 10.000 euro.

Për lëshimin e licencës për klub me automatë, kompensimi rritet nga **78.750 euro në 100.000 euro**. Organizatori i lojërave të fatit në klubet me automate ka të drejtë ta rrisë numrin e hapësirave afariste, ku për hapjen e çdo hapësire të re afariste paguan kompensim në vlerë prej **30.000 eurove** në kundërvlerë me denarë.

Gjithashtu, në propozim ligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Lojërat e Fatit dhe Lojërat Argëtuese, propozohet të rritet detyrimi për lojërat e fatit të llotarisë nga 4% në 6% të pagesave të përgjithshme të kryera. Në ligjin aktual neni 39 thuhet: "(1) Për organizimin e lojërave të fatit të llotarisë paguhet taksë e veçantë në shumë prej 4% të pagesave të realizuara të përgjithshme, përkatësisht të mjeteve të grumbulluara nëpërmjet shitjes së biletave të llotarisë, në bazë mujore. Në propozim ligj thuhet: "Neni 16: Në nenin 39 në paragrafin (1) fjalët "në vlerë prej 4%" zëvendësohen me fjalët "në vlerë prej 6%". Pra që nënkupton se do të ketë rritje të taksës së veçantë nga 4% në 6% për lojërat e fatit të llotarisë.

Distanca

Pika kryesore që ne vlersojmë se po ngjall polemika, është propozimi për distancën e lokacioneve të hapësirave afariste nga objektet shkollore, që deri më tani nuk ka qenë e përcaktuar me ligj. Sipas propozimit të Qeverisë, hapësirat afariste duhet të kenë distancë prej 500 metrave rrugë ajrore me shkollat fillore dhe të mesme. Kjo me qëllim që, sipas Qeverisë, të rinjtë të mbrohen dhe të mos kenë qasje të lehtë deri tek “veset e këqija”. Pra në nenin 21, pas paragrafit 1 shtohen tre paragrafë të rinjë (2, 3 dhe 4) të cilët e përcaktojnë distancën midis lokaleve afariste dhe objekteve të shkollave fillore dhe të mesme. Mënyra e matjes së distancës sipas propozimit të qeverisë do të përcaktohet me rregullore, që miratohet nga Ministri i Financave. Kjo pikë ka gjetur përkrahjen e Lëvizjes Antibixhoz ndërsa ka ngjallur reagimin e Asociacionit të punonjësve të lojërave të fatit dhe kazinove në Republikën e Maqedonisë së Veriut të cilët thanë që do të humben rreth 10,000 vende të punës. (2)

Edhe pse distanca prej 500 metrash nga objektet shkollore do të ndikojë në largimin e një pjese të konsiderueshme të objekteve të lojërave të fatit nga qendrat e qyteteve dhe mund të reduktojë deri në një masë ekspozimin e njerëzve ndaj këtyre objekteve, ne parashtrojmë dilemën se a do të zgjidhë në realitet kjo problemin e ekspozimit të fëmijëve ndaj lojërave të fatit. Ne kemi bërë një paraqitje grafike online të perimetrit të shkollave dhe objekteve të lojërave të fatit nëpërmjet hartës interaktive që mund të qaset në web-faqen www.nocasinozone.info. Nëpërmjet kësaj harte mund të shihet cilat objekte të lojërave të fatit do të ndikohen nga propozim ligji ndërsa kjo hartë do të shërbejë edhe si mbikqyrës i implementimit të ligjit nëse ai kalon në parlament. Duhet pasur parasysh që të dhënat në këtë vizualizim janë marrur kryesisht nga ato që kanë ekzistuar online dhe lista nuk është shterruese.

Në foto ekstraktin më posht është qyteti i Kumanovës. Në total në Kumanovë me ligjin e ri për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese do të duhet të riallokohen gjithsej tetëmbëdhjetë (18) hapësira afariste në të cilat organizohen lojëra të fatit.

2.<https://tv21.tv/lojerat-e-fatit-500-metra-larg-objekteve-shkollore-antibixhozi-e-pershendet-apis-10-mije-persona-do-te-mbeten-pa-pune/>

Figura 1. Qyteti i Kumanovës






Figura 2 më posht është qyteti i Tetovës e cila tregon që në rast se propozim ndryshimet e Ligjit miratohen do të mbyllet apo do të duhet të ndryshojnë lokacion tridhjet e shtatë (37) hapësira afariste brenda të cilave luhet bixhoz. Gjithashtu edhe në qytetin e Gostivarit, do të duhet të rialokohen trembëdhjet (13) hapësira afariste, në qytetin e Strugës katërmëdhjetë (14), në Kërçovë nëntë (9) etj.

Figura 2. Qyteti i Tetovës



Në figurën 3 më posht është Komuna e Çairit. Në komunën e Çairit do të duhet të ndryshojnë lokacion trembedhjet (13) hapësira afariste që organizojnë lojëra fati dhe bixhoz. Interesant është fakti që në figurën më poshtë mund të shihet edhe medreseja "Isa Beu", e stacionuar në Çarshinë e Vjetër të Shkupit, farë pranë objektit të kompanisë së lojërave të fatit "Senator" e cila do të duhet të mbyllet sipas ligjit të ri, por jo më larg se disa ditë më parë, aty afër 150 metra distancë, te një lokal pranë bustit të Skenderbeut u sollën edhe aparatet e reja për lojëra të fatit dhe flitet për hapjen e një lokacioni të ri për lojëra të fatit. Mbetet e paqartë nëse investitorët kanë qenë të vetëdijshëm që me ligjin e ri ky objekt do të duhet të mbyllet, apo ndoshta medreseja Isa Beu nuk konsiderohet shkollë normale ku nxënësit ndjekin mësim.

Figura 3. Komuna e Çairit



Distanca e propozuar me propozim ndryshimet e Ligjit ishte edhe temë diskutimi në intervistën tonë kualitative me Lëvizjen Antibixhoz. Bashkëbiseduesit thanë se dispozita ligjore rreth distancës nga objektet shkollore është një hap përpara dhe sado pak e çon përpara idenë dhe qëllimin e tyre, e që është mbyllja e plotë e kazinove. Megjithatë, ata thanë se nuk e shohin këtë zgjidhje si përfundimtare dhe veprimtaria e tyre do të vazhdojë deri në mbylljen totale të lojërave të fatit.

Çfarë është bixhozi: një zakon i keq apo një sëmundje me varshmëri?

Çrregullimi nga lojërat e fatit është klasifikuar si sëmundje në rishikimin e 11 të Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve (ICD-11) të miratuar nga Asambleja e 72-të Botërore e Shëndetësisë (WHA72) më 2019.

Bixhozi është në të shumtën e rasteve një sëmundje me varshmëri që karakterizohet nga nevoja gjithnjë në rritje për të luajtur kumar. Në vitin 2013, Manuali Diagnostik dhe Statistikor i Çrregullimeve Mendore i Shteteve të Bashkuara të Amerikës e njohu zyrtarisht varësinë nga kumari si një çrregullim të shëndetit mendor (3). Psikologë të ndryshëm, thonë se shprehia për të luajtur bixhoz lidhet me rritjen e nivelit të dopaminës e cila është një kemikat i trurit i cili rrit ndjenjën e kënaqësisë dhe motivimit (4). Te njerëzit e varur nga bixhozi kjo kemikat rritet kur ata luajnë bixhoz. Sipas një studimi personat që kanë varshmëri nga bixhozi kanë një gjendje më të rëndë të shëndetit mendor sesa njerëzit që nuk luajnë (Bonnaire et al., 2017). Shpesh këto njerëz kanë personalitet antisocial dhe shfaqin më shumë sjellje impulsive dhe agresive sipas të njëjtit studim.

Një studim tjetër i zhvilluar nga Hodgins, Stea, & Grant (2011) thotë se bixhozi është një sëmundje kronike dhe komplekse që mund të shkaktojë pasoja të rënda në jetën e njerëzve. Gjithashtu nëpër studime të ndryshme thuhet se ka një lidhje të theksuar midis bixhozit dhe dhunës në familje. Për këtë ka edhe shumë emisione nëpër mediat televizive që emitohen në formë të intervistave dhe rrëfimeve se si bashkshortët kumarxhinjë terrorizojnë dhe keqtrajtojnë familjet e tyre si rezultat i varshmërisë nga bixhozi (5). Sipas një studimi të kryer në Zelandën e Re në vitin 2016–2017, dëmi që shkaktohet nga lojërat e fatit ishte 2.5 herë më i madh se dëmet që shkaktohen nga diabeti dhe 3 herë më i madh se dëmi që shkaktohet nga droga (Bellringer et al., 2020). Kjo për shkak se dëmi që shkaktohet lidhet kryesisht me ndikimet financiare, dëmtim të mardhënieve me njerëzit, shqetësime emocionale dhe psikologjike si dhe dëmtim të reputacionit në raport me punën dhe familjen.

Cilët faktor ndikojnë në zhvillimin e këtyre zakoneve?

Të predispozuar drejt lojërave të fatit apo bixhozit sipas studimeve që janë kryer, por edhe sipas prononcimeve të sociologëve të ndryshëm, kryesisht

3. <https://www.addictionhelp.com/gambling/>

4. <https://www.youtube.com/watch?v=BF5SziN63w8>

5. <https://www.youtube.com/watch?v=2xrGgBG0ZKY>

radhiten njerëzit e papunësuar, njerëzit pa arsimim të mirëfillt, me të ardhura të ulëta, të rinjtë minorent, dhe posaçërisht ata që jetojnë afër lojërave të fatit. Pra studime të caktuara pohojnë se ka disa faktorë që ndikojnë që njerëzit të luajnë bixhoz. Ata mund të jenë faktor social si varfëria, papunësia, problemet financiare, stresi, ankthi depresioni etj. Një faktor tjetër është teknologjia e cila e ka bërë qasjen të lojërave të fatit shumë të lehtë, mjafton që njerëzit të kenë internet dhe smartphone. Pastaj si faktorë tjetër mund të jetë dhe kultura.

Në kontekstin e Maqedonisë së Veriut si faktor dukshëm kyç janë varfëria por edhe prezenca e madhe e kompanive dhe fililaleve të tyre në vendbanime ku ka prani të madhe të qytetarëve. Ashtu sikurse nëse nuk ka alkohol nuk ka njerëz të dehur, po ashtu edhe nëse nuk ka bixhoz dhe kazino nuk ka bixhozxhinjë. Reklamimi dhe promovimi i bixhozit nëpër televizione, radio, nëpër autobusë publik, prania e tyre afër shkollave, institucioneve fetare, qendrave të qyteteve e stimulon një qytetarë të rëndomtë të futet në labirinthe të bixhozit. Ne kemi marrur një prononcim nga sociologu dhe profesori universitar Ali Pajaziti në lidhje me këtë fenomen, të cilin e kemi pyetur se si e sheh ai nga këndvështrimi i një sociologu praninë e madhe të kazinovave dhe industrisë së lojërave të fatit në përgjithësi. Sipas sociologut në fjalë:

“Lojërat e fatit hapen në vendet dhe shoqëritë e varfra dhe me shkallë të lartë të papunësisë, por pasojat nga devijime të tilla janë katastrofale për familjet dhe shoqërinë, në përgjithësi. Bastoret dhe kazinotë janë lokalë vrastare, ka raste të divorceve, të zënkave në familje, të dhunës, deri të falimentimit e njerëzve që dikur kanë qenë afaristë, ndërsa sot kërkojnë një cigare nga tjetri. Kjo gjendje që po na ndodh, është shumë tragjike pasi në vend se ne të hapim institucione kulturore, shkolla, çerdhe për fëmijë, neve na hapen lokale vrastare.”

Bixhozi dhe të miturit

Ligji për Lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut e ndalon praninë e të miturve në objektet e lojërave të fatit. Çdo person që dëshiron të futet në kazino duhet të nënshtrohet një kontrolli identifikimi në hyrje ashtuqë të verifikohet mosha e tyre. Megjithatë, rastet kur të miturit janë pjesmarrës në lojërat e fatit nuk janë shumë të rralla. Sipas një ankete të realizuar nga MOF (Forumi Rinor Arsimor) me 90 të rinjë prej moshës 15-18 vjeç dhe 662 të rinjë prej moshës 18-24 vjeç, në pyetjen se “A keni hyrë deri më tani në lokale të lojërave të fatit?” me “Po” janë përgjigjur 414 të rinjë (58%) dhe me

“Jo” janë përgjigjur 296 të rinjë (42%).(6) Një anketë tjetër e realizuar nga Shoqata e Punëtorëve Social të qytetit të Shkupit në bashkëpunim me klubet e shoqatës për alkoholikët e shëruar, ka intervistuar 4.000 të nxënës të shkollave të mesme, nga tetë qytete të Maqedonisë së Veriut. (7) Në pyetjen se “A keni luajtur ndonjëherë ndonjëherë nga lojërat e fatit?” 2.565 apo 69% janë përgjigjur me “Po” dhe 1.135 apo 30% janë përgjigjur me “Jo”. Disa nga të dhënat tjera mbi këtë temë janë:

- 446 apo 13% prej të anketuarve kanë filluar të luajnë lojëra të fatit në moshën 14 vjeçare;
- 460 apo 12% kur i kanë pasur 15 vjet;
- 321 apo 9% kur i kanë pasur 13 vjet.

Në pyetjen se cilin lloj të lojërave të fatit e kanë luajtur më së shumti përgjigjet kanë qenë si vijon:

Kazino	253
Lloto	1070
Poker	98
Lojëra në automatë	150
Bastore sportive	921
Nuk ka përgjigje	1232

Edhe sociologu Ali Pajaziti aludoi që problemi me bixhozin prek moshat e reja, me ç’rast ai theksoi: *“Kemi të bëjmë me një botë iluzore që po përhapet si orteku që po përfshin në veçanti pjesën më vitale të shoqërisë, rininë, e cila për fat të keq tanimë punën, djersën e derdhur për kafshatë ka filluar t’i perceptojë si diçka demode, e tejkaluar.”*

Pra, studime të ndryshme por edhe opinione të njerëzve relevant tregojnë që të miturit dhe të rinjtë në përgjithësi janë pre e lojërave të fatit me çka që në moshë të re krijohet mvarshmëria me pasoja afatëgjate.

6.<https://www.radiomof.mk/igri-na-nesrekja-pomegju-kazina-i-uchilishta-kolku-se-misli-na-mladite/?fbclid=IwAR2tmpJllhr-qezo7iud7AWK7fkdxlepKDOM8jKA02yQUtwenL3hmiQ7slo>

7.<https://repository.ukim.mk/bitstream/20.500.12188/24639/1/%D0%9F%D1%83%D0%B1%D0%BB%D0%B8%D0%BA%D0%B0%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0.pdf>

Bixhozi dhe veprat penale

Më 24 prill 2023, Instituti për Demokraci dhe Analiza Ekonomike ka dërguar kërkesë për qasje në informacione me karakter publik te Ministria e Punëve të Brendshme, të cilën e kemi pyetur për numrin e veprave penale të kryera në objektet ku organizohen lojërat e fatit, se a kanë pasur raste kur të miturit janë gjetur në objekte të lojërave të fatit, nëse bixhozxhinjtë ushtrojnë dhunë në familje dhe nëse janë shqiptuar gjopa për kompanitë e lojërave të fatit. Ministria e Punëve të Brendshme kërkesës sonë i është përgjigjur më datë 09 maj 2023.

Sipas të dhënave në periudhën nga viti 2021 deri më datë 04.05.2023, janë regjistruar tri (3) vepra penale për kompanitë që organizojnë lojëra të fatit, për të cilat janë denoncuar 17 autorë. Sa i përket veprave penale të kryera në Kazino nga përfundimi i vitit 2022 dhe katër muajt e parë të vitit 2023, janë regjistruar gjithsej 37 vepra penale, ku objekt sulmi ka qenë vetë kazinoja. Pjesa më e madhe e veprave penale kanë qenë vepra penale “vjedhje”, “vjedhje e rëndë”, “grabitje”.

Raste të veprave penale nëpër objekte të lojërave të fatit vërehen jo-rrallë. Jo më larg se me datë 31 mars 2023, një person nga Haraçina mbeti i vrarë në një kazino në lagjen Kapishtec të Shkupit. 46 vjeçari nga Haraçina u vra nga një person tjetër me të cilin kishin luajtur në aparate deri në orët e mëngjesit. Më 18 mars të vitit 2022 dy të rinjë nga Tetova pasi humbën shuma të mëdha në një kazino në Tetovë, filluan të demolojnë objektin dhe në fund hodhën benzinë dhe e dogjën kazinon. (8) “Më 15 shkurt të vitit 2020, në ora 04:47 të SPB Shkup, u denoncua se katër persona të armatosur kanë hynë në kazino në rr. ‘Magjistralka e Adriatikut’ në Shkup dhe kanë filluar të qëllonin ndaj të pranishmëve, duke goditur V.H. (22) nga Kosova, i cili ka vdekur në vend ngjarje. Ndërsa, sipas denoncimit, B.N. (20) nga fshati Krushopek, Shkup, i angazhuar si sigurim privat në kazino, është goditur në kokë me kondak dhe ka ndërruar jetë. (9)

Siç mund të shohim në përgjigjet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, por edhe nga lajmet nëpër mediat e vendit, jo rrallë ndodh që objektet ku luhen lojërat e fatit, janë edhe skena krimi dhe vrasje. Kjo mund të vie si rezultat i asaj

8. <https://novatv.mk/drama-vo-tetovo-dvajtsa-izgubile-golema-suma-na-pari-zapalile-kazino-politsaets-za-vlakno-spasil-zhiva-glava/>

9. <https://sinjali.com/vritet-22-vjecari-nga-kosova-ne-nje-kazino-ne-shkup/>

se njerëzit aty kur i humbin të gjitha paratë gjithashtu e humbin edhe racionalitetin si pasojë e dëshprimit që i kaplon. Ajo që dihet është se kazinot nuk janë aty që njerëzit të pasurohen, por që të varfërohen. Për fat të keq shteti nuk ka ndërmarrë asnjë masë konkrete preventive që këto krime të mos përsëriten.

Numri i kompanive të lojërave të fatit

Me datë 17.05.2023 , IDEA ka dërguar kërkesë për qasje në informacione me karakter publik deri tek Ministria e Financave ku kemi kërkuar numrin e kompanive që organizojnë lojëra fati dhe sa lokacione ka secila prej tyre. Më 05.06.2023, Ministria e Financave është përgjigjur duke dhënë informacionet të cilat janë të përmbledhura në Tabelën 3.

Siç mund të shihet më poshtë, në Republikën e Maqedonisë së Veriut kemi 4 kazino të licencuara me 6 hapësira pune ku organizohen lojërat në kazino. Po ashtu, ekzistojnë 7 kompani që organizojnë lojëra të fatit në bastore me 740 vend pagesa apo lokacione. Përveç kësaj ekzistojnë edhe 24 kompani të licencuara që organizojnë lojëra fatit në klube me automat me gjithsej 346 hapësira pune apo lokacione ku qytetarët mund të luajnë. **Pra një total ekzistojnë gjithsej 1,092 lokacione të natyrave të ndryshme, pa ia llogaritur këtu edhe pikë pagesat e llotarisë shtetërore.**

Tabela 3. Numri i kompanive dhe objekteve të lojërave të fatit

	Numri i kompanive	Filialet/hapsira pune
Kazino	4	6
Bastore sportive	7	740
lojëra të fatit me automate	24	346
Llotaria Shtetërore (2021)	1	324
Totali	36	1.416

Kazinot nëpër shtete të ndryshme dhe praktikat e mira

Përhapja masive e lojërave të fatit duket që lidhet ngushtë me nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik të shteteve. Një ndër shtetet më të pasura dhe më tërheqëse në botë siç është Zvicra, me 8.7 milion banorë, ka gjithësj nëntëmbëdhjet (19) kazino (10). Në Principatën e Monakos, ku besohet se 30% e banorëve janë milionerë, bixhozi është i ndaluar për banorët vendas dhe lejohet vetëm për vizitorët (11). Në Gjermani, Ligji për Lojërat e fatit konsiderohet si pjesë e ligjit për rendin publik dhe rregullohet në nivel shtetëror në secilin prej landave. Kazinot licencohen dhe mbikëqyren nga Ministria e Brendshme, kurse makinat slot apo kazinot elektronike mbikëqyren nga zyrat e bashkive.

Në Shqipëri, 31 dhjetori 2018 ishte dita e fundit për bastet dhe kazinot pasiqë qeveria Rama i ndaloi plotësisht lojërat e fatit në Shqipëri. Ato lejoheshin vetëm në hotele me pesë yje, por si duket qeveria atje tani ka ndryshuar mendim sepse lojërat e fatit në Shqipëri do të rihapen sërish me projektligjin e ri i cili parashikon rikthimin e basteve sportive vetëm online dhe dhënien e së drejtës për ta ushtruar këtë aktivitet vetëm 10 operatorëve. Justifikimi nga zëvendësministrja e Ekonomisë dhe Financave Vasilika Vjero, ishte se ndalimi me ligj i lojërave të fatit kishte bërë që lojërat e fatit të funksiononin në mënyrë ilegale. Megjithatë kjo mbetet vetëm supozim, pasi nuk kemi parë ndonjë raport-analizë që e vërteton një gjë të tillë, prandaj kjo duhet marrurr me rezervë.

Ndërsa në Kosovë më 28 mars 2019, me 69 vota për, asnjë kundër, është votuar në parlament ligji që ndalon lojërat e fatit për një periudhë dhjetë vjeçare, i cili hyri në fuqi më datë 10 maj 2019 (12). Kjo erdhi si rezultat i një peticioni të organizuar nga qytetarët e Suharekës, të cilët dorëzuan në kuvendin e Republikës së Kosovës mbi 11.500 nënshkrime (13). Mbyllja e lojërave të fatit në Kosovë siç duket po shfrytëzohet mirë nga ana e kompanive që organizojnë lojëra fati në Maqedoni, pasi rruga që shpie nga Shkupi në kufirin me Kosovën tashmë është mbushur me kazino dhe objekte afariste që organizojnë lojëra fati, që të jetë qasja sa më e lehtë edhe për shtetasit e Kosovës që luajn bixhoz. Madje edhe selia e re Lloatrisë Shtetërore do të vendoset në atë zonë të Shkupit.

10. <https://www.worldcasinos.info/switzerland/>

11. <https://www.gamblingjudge.com/monaco-gambling-sites-and-laws/#6>

12. <https://ekonomiaonline.com/nga-sot-ska-me-lojera-te-fatit-ne-kosove-hyn-ne-fuqi-ligji-per-ndalimin-e-tyre/>

13. <https://klankosova.tv/qeveria-mbyll-lojerat-e-fatit-per-10-vjet-video/>

Akuzat e opozitës

Opozia në përgjithësi, po në veçanti ajo shqiptare disa herë ka drejtuar akuza në drejtim të qeverisë, respektivisht të zëvendëskryeministrit të parë Artan Grubi, që ai qëndron prapa industrisë së lojërave të fatit nëpërmjet drejtorit të Llotarisë Shtetërore Përparim Bajrami, i cili paraprakisht ka qenë i punsuar në kabinetin e zëvendëskryeministrit Grubit.

Me Ligjin aktual të Lojërave të Fatit dhe Lojërave argëtuese, kompanitë ekzistuese nuk mund të organizojnë lojëra të fatit online, pasi që këtë të drejtë e ka ekskluzivisht Llotaria Shtetërore, e cila së fundmi pati një thirrje publike me 11 shtator 2023 për përzgjedhjen e tre organizatorëve të lojërave të fatit në internet (14). Në thirrjen e Llotarisë Shtetërore, parashihen kushte të përgjithshme dhe të veçanta në tenderim. Ajo që bie në sy është se një ndër kushtet është që ofertuesi, në këtë rast kompania që garon në tender, të ketë të ardhura nga organizimi i lojërave të fatit në internet të paktën dyzet (40) milionë në total në tre vitet e fundit (2020-2022). Kusht tjetër është që kompania që konkurren të ketë tetë (8) vjetë përvojë në mbështetjen për zhvillimin dhe marketingun e një platforme online si dhe përmbajtjet e lojërave të fatit në dy vende të Evropës, njëri prej të cilave në Ballkanin perëndimor. Kjo automatikisht i përjashton kompanitë vendase, të cilat tashmë dihet se nuk kanë organizuar lojëra të fatit online, pasi këtë të drejtë e ka ushtruar Llotaria Shtetërore, me çka siç akuzon opozita, i hapen dyert kompanive të huaja, apo “nëntokës sërbe dhe bullgare”, që të futen në industrinë vendase të organizimit të lojërave të fatit. Më posht keni disa linqe ku opozita ka lëshuar akuza drejt qeverisë për futjen e kompanive të huaja në tregun vendas për organizimin e lojërave të fatit online (15,16,17).

Të hyrat dhe fitimet e kompanive të lojërave të fatit

Edhe pse ka pasur tentativa sporadike, të hyrat e kompanive që organizojnë lojëra të fatit fatkeqësisht nuk janë kuantifikuar dhe vërtetuar asnjëherë në tërësi. Kjo ka ndodhur sepse nuk ka pasur ndonjë hulumtim gjithpërfshirës në këtë aspekt deri tani, por edhe si pasojë e mungesës së transparencës meqë

14. <https://plusinfo.mk/wp-content/uploads/2023/09/aven-povik-Drzhavna-Lotari-a-na-Makedoni-a.pdf>

15. <https://shqip.republika.mk/me-te-cilet-qeveria-planifikon-te-behet-partner-cerepot-ka-kazino-pika-bastesh-automjete-luksoze-dhe-antike-jane-pasioni-i-tij/>

16. <https://telegrafi.com/mexhiti-kasami-dhe-gashi-nuk-po-ndertohen-spitale-shkolla-salla-sportive-artan-grubi-po-hap-tre-rrjete-te-reja-te-kazinove/>


17. <https://klanmacedonia.mk/vmro-pushteti-bdi-lsdm-permes-grubit-sjell-nentoken-bullgare-ne-maqedoni-permes-kazinove/>

një pjesë e kompanive të cilat organizojnë lojëra të fatit nuk dorëzojnë raporte financiare në Regjistrin Qendror ku mund të merren të dhënat. Prandaj nuk dihet saktë sa është shuma totale e të hyrave të kompanive të lojërave të fatit, e cila po ashtu do të ishte edhe një tregues proksi i shumës së të hollave të cilën qytetarët e shpenzojnë në lojëra të fatit.

Në përpjekjen tonë për të hedhur dritë mbi të hyrat e kompanive në industrinë e lojërave të fatit dhe për të parë se sa para harxhojnë qytetarët në bixhoz, me datë 22 dhjetor 2023 kemi dërguar kërkesë deri te Regjistri Qendror për t'i blerë raportet e shkurtëra financiare të të gjitha kompanive me shifër veprimtarie 92, e cila është shifra e veprimtarisë së kompanive të cilat organizojnë lojëra të fatit. Me datë 26 dhjetor Instituti IDEA ka pranuar raportet e shkurtëra financiare të 56 kompanive nga gjithësej 95 kompani (59% të kompanive totale) të cilat organizojnë lojëra të fatit, meqe pjesa tjetër e kompanive nuk kanë dorëzuar raporte financiare tek Regjistri Qendror për vitin 2021 dhe 2022. Prandaj, është e vështirë për ta përcaktuar shumën e saktë të hyrave të kompanive të lojërave të fatit, por megjithatë ne do të përpiqemi të bëjmë një përafrim të pasqyrës së përgjithshme të kësaj industrie.


Të dhënat tregojnë se të hyrat totale të 56 kompanive për vitin 2021 ishin 556,115,216 euro, ndërsa ato u rritën në 690,885,917 euro në vitin 2022, apo një rritje prej 21% (Figura 4). Përkthyer në ditë, kjo i bie që për çdo ditë gjatë vitit 2022, 55 kompanitë e lojërave të fatit kanë realizuar nga 1,701,711 euro. Nëse bëjmë një supozim konzervativ dhe themi që na mungojnë edhe 10% e të hyrave nga kompanitë të cilat nuk kanë dorëzuar raporte financiare tek Regjistri Qendror (pra 40 kompani), atëherë i bie që të hyrat vjetore të industrisë së lojërave të fatit të jenë përafërsisht 810,004,179 euro, apo kompanitë e lojërave të fatit të kenë realizuar mesatarisht nga 2,219,189 për çdo ditë. Megjithatë, kjo mbetet në nivelin e supozimit meqë qasje në të dhëna të tilla nuk kemi.

Figura 4. Të hyrat totale të 56 kompanive që organizojnë lojra të fatit (euro)




Në anën tjetër, Figura 5 më poshtë paraqet 15 kompanitë të cilat kanë realizuar të hyrat më të larta nga 56 kompanitë e hulumtuara në industrinë e lojërave të fatit. Këto kompani në vitin 2022 kanë realizuar 90% të të hyrave të tërësishme të industrisë së lojërave të fatit, një rënie prej 2 pikë përqindje nga viti 2021. Tre kompanitë më të mëdha janë Pro-Beting DOO, Sport Life Treid DOO dhe Kazinos Austria DOO. Rritjen më të madhe të të hyrave krahasuar me vitin 2021 e ka realizuar kompania Pro-Beting DOO me rritje prej 52,356,896 eurove apo 55.83% të të hyrave krahasuar me vitin 2021.

Figura 5. Të hyrat e 15 kompanive më të mëdha (euro) që përbëjnë 90% të të hyrave totale të 56 kompanive



Tre kompanitë më të mëdhaja kanë realizuar 45% të të hyrave të përgjithshme të industrisë së kazinove apo 309,743,189 euro.


Figura 6. Proporcioni i të hyrave në mes të 3 kompanive më të mëdhaja dhe pjesës tjetër të industrisë, 2022



Të hyrat dhe fitimi

Kompanitë e lojërave të fatit në Maqedoninë e Veriut duket që kanë margjinë profiti relativisht të ulët dhe çuditërisht volatile. Në vendet tjera të botës, margjina e profitit (profiti/të hyrat), sillet prej diku 18% deri në 30%, ndërsa në Maqedoninë e Veriut margjina totale e profitit duket të jetë shumë më e ulët, edhe atë prej 8.30% në vitin 2022 dhe 6.81% në vitin 2021. Kompanitë me të hyra relativisht të larta, siç është për shembull kompania “Pro Beting” në vitin 2022 ka realizuar të hyra prej 146,130,304 euro ndërsa profit prej vetëm 240,574 euro apo 0.16% margjinë profiti. Po ashtu, kompania “Zlatna Kopačka Eden DOO” ka realizuar gjithsej 31,207,446 euro të hyra në vitin 2022 ndërsa vetëm 52,163 euro fitim, apo marzhë profiti prej 0.17%. Këto të dhëna vendosin pikëpyetje mbi mundësinë e evazionit fiskal duke e ditur që kompanitë e lojërave të fatit në vende tjera kanë margjina fitimi minimal dyfishore (18).


Figura 6. Të hyrat dhe fitimi i 55 kompanive (euro)



Një element krahasimi mund të jetë margjina e profitit të Llotarisë Shtetërore e cila në vitin 2022 kishte një margjinë profiti prej 56.79%, ndërsa kompanitë me të hyrat më të larta në treg kishin margjinë profiti që nuk arrinte as 1%. Pra, margjina e profitit në Llotarinë Shtetërore tregon që në industrinë e lojërave të fatit mund të operohet me margjinë shumë më të lartë profiti, prandaj parashtrohet pyetja përse margjinat e profitit në kompanitë private të lojërave të fatit janë kaq të ulta?

Dyshimi kryesor mund të vijë për tendencë për ikje të tatimit dhe shpërlajre të parave. Pra, kompanitë e lojërave të fatit mund të angazhojnë kompani të lidhura me pronarët e tyre që të kryejn shërbime pa pasur nevojë për ato shërbime në mënyrë që të rriten shpenzimet dhe mos të paguhet tatim mbi to, por edhe të futen në sistem para të cilat mund të jenë të fituara në mënyra të jashtëligjshme.

Figura 7. Margjinat e profitit të kompanive private krahasuar me Llotarinë Shtetërore, 2022



Llotaria e Maqedonisë

Llotaria e Maqedonisë është shoqëri aksionare për organizimin e lojërave të fatit, me të drejta, detyra dhe përgjegjësi të caktuara me ligjin për Shoqëri Tregtare, Ligjin për Lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese dhe statutin e Shoqërisë Aksionare për organizimin e lojërave të fatit në pronësi të shtetit.

Kjo shoqëri është plotësisht në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Qëllimi primar dhe i vetëm i kësaj shoqërie Aksionare është organizimi dhe përgaditja e lojërave të fatit. Shoqëria aksionare Llotaria Shtetërore është themeluar me vendim të Qeverisë më 26 qershor 2007. Kapitali bazë i Llotarisë është 276.345.000 denarë, gjegjësisht 4.500.000 euro. Kapitali aksionar është i ndarë në 45.000 aksione të zakonshme në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut me një vlerë nominale prej 100 euro sipas kursit të mesëm të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (marrur nga raporti vjetor i Llotarisë së Maqedonisë).

Më datë 24 prill të vitit 2023, kemi dërguar kërkesë për qasje në informacione me karakter publik deri tek Llotaria Shtetërore, të cilën e kemi pyetur për lojërat e fatit që i realizon Llotaria Shtetërore. Kërkesës tonë i janë përgjigjur më datë 10 maj 2023.

Lojërat e fatit Llotaria Shtetërore i realizon përmes rrjetit primar të shitjes (shitjes direkte) të cilën e përbëjnë dhjetë pikëpagesa dhe rrjetit sekondar të shitjes (shitjes indirekte) e cila realizohet përmes bashkëpunorëve, në kuadër të së cilës janë 294 vende të pikëpagesave. Për realizimin e organizimit të lojërave të fatit nëpërmjet internetit, Llotaria Shtetërore ka 185 pikëpagesa një prej të cilave e përbën rrjetit primar të shitjes dhe 184 realizohen nëpërmjet bashkëpunorëve në kuadër të rrjetit sekondar të shitjes.

Gjithashtu Llotaria Shtetërore e Maqedonisë shfrytëzon platforma online si mënyrë e pagesës për lojërat e fatit Loto 7/37 dhe lojën e xhokerit.

Pagat e Drejtorit dhe organeve tjera të Llotarisë së Maqedonisë

Sipas raportit vjetor të vitit 2021, paga bruto e Drejtorit të Përgjithshëm është: 141,036 denarë apo 2,293 euro, ndërsa paga e zëvendës-drejtorit të përgjithshëm ishte 112,569 denarë apo 1,830 euro. Meqë raporti vjetor i vitit 2023 ende nuk është publikuar, mund të supozojmë që me rritjet e fundit të pagave të funksionarëve, pagat bruto të Drejtorit dhe zv. Drejtorit aktualisht duhet të jenë 4,082 euro dhe 3,258 rrespektivisht.

Në datë 31.02.2022 në Llotarinë Shtetërore të Maqedonisë së Veriut të punësuar figurojnë 75 persona. Bruto paga mesatare është përafërsisht 60,000 denarë.

Të hyrat dhe fitimet e Llotarisë së Maqedonisë ndër vite

Të hyrat e Llotarisë Shtetërore kanë pasur rritje të vazhdueshme nga viti 2017 deri në vitin 2022, edhe atë me mesatarisht nga 23% për çdo vit.

Figura 7. Të hyrat e Llotarisë Shtetërore nga lojrat e fatit (euro)





Figura 8. Të hyrat dhe fitimi i Llotarisë Shtetërore (euro), 2020-2022




Në raportin vjetor të vitit 2021 të Llotarisë thuhet: “Në një kohë pandemie globale, ku ekonomia po përjeton një rënie serioze në të gjitha anët viti 2021 është viti më i mirë për sa i përket pagesave të lojërave të Llotarisë.” (19)

Numri i të punësuarve në industrinë e lojërave të fatit

Sipas të dhënave zyrtare të marra nga Regjistri Qendror i Maqedonisë, në industrinë e lojërave të fatit (pra në 55 kompani të cilat kanë dorëzuar raporte financiare), në vitin 2021 ka pasur gjithësej 7,382 të punësuar, ndërsa ky numër është rritur për 3.21% dhe në vitin 2022 numri i përgjithshëm i të punësuarve ishte 7,619. Në anën tjetër nga përfaqësuesit e Asociacionit të Punonjësve të Lojërave të Fatit dhe Kazinove thonë që numri i të punësuarve në këtë industri është diku 10,000 të punësuar. Kjo edhe mund të jetë e vërtetë, meqë të dhënat tona bazohen në 56 nga 95 kompani dhe nuk e përjashtojmë faktin që numri i të punësuarve mund të jetë edhe më i madh.

Figura 9. Numri i të punësuarve në industrinë e lojërave të fatit (55 kompani)




Lojërat e fatit dhe kreditë e shpejta

Lidhja ndërmjet industrisë së kazinove dhe kredive të shpejta është aluduar shpesh të jetë disa dimensionale. Të dhënat e suguruara nga Ministria e Financave tregojnë që numri i kredive të shpejta ka pasur rritje të vazhdueshme në pesë vitet e fundit, përveç vitit 2020 kur njerëzit ishin të detyruar të qëndronin në shtëpitë e tyre si pasojë e pandemisë të shkaktuar nga virusi COVID-19.

Kjo asocon në një lidhje direkte me lojërat e fatit, meqë edhe pse ishte kohë krize ekonomike, për çudi numri i kredive të shpejta të marra u zvogëluar për 17.76%.

Supozimi ynë është që meqë objektet e lojërave të fatit ishin të mbyllura dhe njerëzit në masë të madhe nuk mund t'i frekuentonin ato, edhe numri i kredive të shpejta ka rënë gjatë atij viti. Nëse i referohemi të hyrave të Llotarisë më lartë, shohim që viti 2020 ishte viti i vetëm ku të hyrat e Llotarisë nuk kishin shënuar rritje të konsiderueshme, pra që korrespondon me supozimin që bëmë deri tani. Megjithatë, të dhënat e kompanive private të lojërave të fatit nuk janë të qasshme dhe prandaj nuk mund të bëjmë analizë më të thellë në këtë drejtim.

Figura 10. Numri i kredive të shpejta të dhëna nga shoqëritë financiare, 2018-2022



Lidhshmëria e industrisë së lojërave të fatit me shoqëritë financiare të cilat ofrojnë kredi të shpejta është aluduar të jetë edhe në aspekt të pronisë, ku thuhet që pronarët e kompanive të lojërave të fatit janë bashkë-pronarë edhe të shoqërive financiare të cilat e ushqejnë industrinë e lojërave të fatit me kesh të gatshëm. Megjithatë, kjo mbetet në nivelin e spekulimeve meqë të dhëna për t'i vërtetuar këto shpekulime nuk posedojmë si rezultat i mungesës së transparencës.

Përfundim dhe rekomandime

Nga të dhënat e mbledhura dhe të analizuara më lartë mund të konstatojmë që bixhozi në Maqedoninë e Veriut është fenomen jashtëzakonisht i përhapur, gjë që tregohet nga shumat mbi gjysëm miliard euro të hyra të kompanive të cilat organizojnë lojëra të fatit. Pasojat sociale dhe ekonomike veçmë janë të njohura, siç janë vjedhjet, dhuna në familje, apo edhe përfshirja e të miturve në lojëra të fatit. Këto pasoja u konstatuan edhe nga intervista me Lëvizjen Anti-bixhoz si dhe me sociologun Ali Pajaziti.

Në anën tjetër, nga të hyrat e larta dhe profitet jashtëzakonisht të ulta të kompanive mund të konstatojmë që ekzistojnë dyshime të thella mbi kredibilitetin e raportimeve të profitit nga ana e kompanive të lojërave të fatit. Ekzistojnë dyshime edhe për mundësinë që kompanitë e lojërave të fatit të shërbejnë si platformë ku mund të bëhet shpërlarja e parave. Prandaj, duhet të realizohen hulumtime më të detajuara dhe kontrole të mirëfillta financiare nga organet kompetente në mënyrë që të evitohet evazioni fiskal por edhe shpërlarja e parave të fituara në forma të jashtëligjshme.

Ndryshimet e Ligjit rrisin koston e operimit të kompanive që organizojnë lojëra të fatit, megjithatë nuk e zgjidhin problemin të cilin e paraqet bixhozi dhe mvarshmëria nga bixhozi. Prandaj, duhet rregullim më strikt i kësaj industrie dhe po ashtu duhet të adresohen edhe problemet themelore që kanë të bëjnë me pasojat sociale dhe ekonomike. Prandaj, inkurajojmë Qeverinë, rrespektivisht Ministrinë për Punë dhe Politika Sociale të krijojë programe speciale të rehabilitimit të personave të varur nga bixhozi, duke filluar me njohjen e varshmërisë nga bixhozi si sëmundje reale meqënëse çrregullimi nga lojërat e fatit është klasifikuar si sëmundje në rishikimin e II të Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve (ICD-11) të miratuar nga Asambleja e 72-të Botërore e Shëndetësisë (WHA72) më 2019. Si shtesë e kësaj pike, rekomandojmë të hapet një zyre e posaçme me të punsuar psikologë e që do të ketë një linjë të hapur telefonike për këshilla për personat që vuajnë nga ky fenomen, si dhe të mund të drejtohen fizikisht për ndihmë në këtë zyrë.

Liberalizimi i tregut të lojërave të fatit, me çka do të rritet konkurenca, jo domosdoshmërisht është gjë e mirë në rastin e lojërave të fatit, meqë atëherë do të hasim në kompani të cilat do të garojnë edhe më shumë në përhapjen e bixhozit duke shkaktuar edhe më shumë pasoja sociale dhe ekonomike tek qytetarët e rëndomtë. Prandaj, instituti IDEA mbështet versione më strikte të rregullimit të industrisë së lojërave të fatit, dhe shkojmë deri në nivel të përkrahjes së mbylljes totale të industrisë së lojërave të fatit në Maqedoninë e Veriut, pra si në modelin e Kosovës dhe Shqipërisë.

Siç e tham edhe më lartë, duket të ketë një lidhje direkte në mes të kredive të shpejta dhe lojërave të fatit, ku shoqëritë financiare që japin kredi të shpejta furnizojnë me të holla qytetarët të cilët luajn lojëra të fatit. Në këtë rast duhet të përmendim edhe personat fizik të cilët japin para borxh personave të mvarur nga lojërat e fatit dhe pastaj konfiskojnë gjësende kur paratë nuk mund tu kthehen. Prandaj, inkurajojmë organet kompetente të shtojnë kontrollin mbi kreditë e shpejta si dhe të adresojnë problemin e fajdeve.

Në anën tjetër, duke pasur parasysh të hyrat e larta dhe profitabilitetin jashtëzakonisht të ulët të kompanive të lojërave të fatit, inkurajojmë Drejtorinë e të Hyrave Publike që të shtojë kontrollin ndaj kompanive të lojërave të fatit si dhe organet tjera kompetente që të jenë vigjilent mbi mundësinë e shpërlarjes së parave që mund të përfshijë kompanitë e lojërave të fatit.

Për fund, konsiderojmë që gjendja aktuale me industrinë e lojërave të fatit paraqet probleme të shumëfishta sociale si dhe ekonomike për shoqërinë dhe për shtetin në tërësi. Prandaj industria e lojërave të fatit duhet rregulluar në formë më strikte që këto pasoja të mund të evitohen.

Referencat

Bonnaire, C., Kovess-Masfety, V., Guignard, R., Richard, J. B., du Roscoät, E., & Beck, F. (2017). Gambling Type, Substance Abuse, Health and Psychosocial Correlates of Male and Female Problem Gamblers in a Nationally Representative French Sample. *Journal of Gambling Studies*, 33(2), 343–369. <https://doi.org/10.1007/s10899-016-9628-4>

Hodgins, D. C., Stea, J. N., & Grant, J. E. (2011). Gambling disorders. *The Lancet (British Edition)*, 378(9806), 1874–1884. [https://doi.org/10.1016/S0140-6736\(10\)62185-X](https://doi.org/10.1016/S0140-6736(10)62185-X)

Bellringer, M. E., Janicot, S., Ikeda, T., Lowe, G., Garrett, N., & Abbott, M. (2020). New Zealand National Gambling Study: Correspondence between changes in gambling and gambling risk levels and health, quality of life, and health and social inequities (NGS Series Report Number 9). Ministry of Health. Source: <https://www.health.govt.nz/system/files/documents/publications/national-gambling-study-secondary-analysis-health-correlates-final-report-7sep20.pdf>

Ligji për Lojërat e Fatit: „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 6p.24/11, 51/2011, 148/11, 74/12, 171/12, 27/14, 139/14, 61/15, 154/15, 23/16 и 178/16. Burimi: <https://dejure.mk/zakon/zakon-za-igrите-na-srekja-i-za-zabavnite-igri-1>

Aneks 1: Lista e kompanive dhe të hyrat vjetore

Emrat e kompanive	Vendi	Të hyrat 2021	Të hyrat 2022
Shoqëria për tregti dhe shërbime PRO-BETING DOO import-eksport Shkup	Shkup - Aerodrom	93,773,407	146,130,304
Shoqëria për shitje dhe shërbime SPORT - LAIF TRADE SH.PK Shkup	Shkup - Kisella Vodë	82,839,785	82,286,860
Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit Video Lotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë - KASINOS AUSTRIA DOO Shkup	Shkup - Gazi Babë	67,387,328	81,326,025
Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit DELTA BET DOO Shkup	Shkup - Karposh	44,215,939	48,395,818
Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime CLUB SPORT 77 import-eksport Sh.PK Manastir	Manastir	35,025,479	36,124,375
Shoqëria për baste sportive dhe lojëra të fatit, tregti dhe shërbime ZLATNA KOPAČKA - EDEN DOO Shkup	Shkup - Kisella Vodë	36,224,696	31,207,446
Shoqëria e lojërave të fatit dhe basteve MA GAMING DOOEL Shkup	Shkup - Qendër	21,264,382	30,235,871
Shoqëria për shitje dhe shërbime BET TU MAR DOOEL Shkup	Shkup - Qendër	31,619,873	29,033,487
Shoqëria për catering, turizëm dhe shërbime MAKOTEN DOOEL Gjevgjeli	Bogorodicë	15,828,362	26,463,161
Shoqëria për hotelieri dhe lojëra të fatit PRINCESS HOTEL AND CASINO DOO Bogorodica, Gjevgjeli	Bogorodicë	17,740,186	26,430,649
Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime SENATOR MACEDONIJA DOO Shkup	Shkup - Aerodrom	20,722,424	25,620,959
Shoqëria për turizëm, hotelieri dhe shërbime MASTERBET DOOEL Shkup	Shkup - Aerodrom	17,035,270	22,295,951
Shoqëria aksionare për organizimin e lojërave të fatit Lotaria shtetërore e Republikës së Maqedonisë së Veriut	Shkup - Qendër	10,301,534	13,610,755
Shoqëria për tregti dhe shërbime APEX MK DOO Shkup	Shkup - Karposh	10,731,884	11,844,174
Shoqëria për hotelieri dhe lojëra të fatit THE - SLOTS DOO Shkup	Shkup - Qendër	8,696,910	10,118,775
Shoqëria për tregti, baste dhe organizim të lojërave të fatit GAMING PROFESSIONAL DOOEL Tetovë	Tetovë	5,261,809	8,555,957
Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit GLOBAL GAMING DOOEL Skopje	Shkup - Gazi Babë	4,722,550	7,872,521

Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit CASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MACEDONIA DOO Shkup	Shkup - Gazi Babë	4,556,236	7,857,700
Shoqëria për shitje dhe shërbime SPORT-LIFE GAMING SHP Shkup	Shkup - Kisella Vodë	3,719,945	7,753,771
Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime CLUB SLOT 77 import-eksport Sh.PK Manastir	Manastir	3,629,027	4,545,375
Shoqëria e hotelierisë dhe turizmit FORTUNA INTERNATIONAL DOOEL Gjevgjeli	Gjevgjeli	1,698,130	4,325,884
Shoqëria për tregti dhe shërbime BANANA KICK DOO eksport-import Tetove	Tetovë	2,162,876	3,531,628
Shoqëria për tregti dhe shërbime CITY CLUB SH.PK Koçani	Koçani	1,965,522	3,336,778
Shoqëria tregtare për lojëra fati, prodhim, tregti dhe shërbime MAKTRIKS import-eksport SH.PK Ohër	Ohër	2,751,190	3,235,482
Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ASTRA ELECTRONIK KOMPANI DOO Shkup	Shkup - Aerodrom	1,294,724	2,831,306
Shoqëria tregtare DIVIEN DOO eksport-import Shkup	Shkup - Karposh	2,110,852	2,791,468
Shoqëria e hotelierisë, turizmit dhe e shërbimeve KAK DOO Shkup	Shkup - Karposh	1,509,942	2,583,692
Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit KAZZINO MOZZART Sh.P.SH	Shkup - Karposh	835,471	2,262,042
Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime KING-SLOT DOOEL Vinica	Vinica	1,447,249	1,772,628
Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit MAX BET DOOEL Shkup	Shkup - Karposh	934,356	1,031,473
Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit KAZINO MERKUR DOO import-eksport Gostivar	Gostivar	1,080,567	1,018,790
Shoqëria për tregti dhe shërbime KING EUROPE DOO import-eksporte Gjevgjeli	Gjevgjeli	379,191	926,734
Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL PRO SPORT DOOEL Shkup	Shkup - Karposh	582,268	773,819
Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime EUROGAMES eksport-import DOOEL Ohër	Ohër	525,164	728,080
Shoqëria për shitje dhe shërbime VAMIKO BET DOOEL Strumicë	Strumicë	523,159	686,452
Shoqëria servise POKERFACE DOOEL Shkup	Shkup - Qendër	361,991	492,756
Shoqëria për prodhim, tregti, lojëra të fatit, hotelieri dhe shërbime JOTON SREQA DOO import-eksport Gostivar	Gostivar	308,312	324,303

Shoqëria për tregti, hotelieri, prodhim dhe shërbime VEMAX TOBACO import-eksport Vecko Srbinoski DOOEL Kërçovë	Kërçovë	157,548	136,449
Shoqëria për hotelieri tregti dhe shërbime LEPACHENCE DOOEL Pehçevë	Pehçevë	105,918	136,178
Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ARENA GAMING DOOEL Strumicë	Strumicë	0	131,337
Shoqëria për hotelieri dhe organizim të lojërave të fatit DIAMOND DS DOOEL Jançishtë, Jegunovcë	Jançishtë	18,651	32,474
Shoqëria për prodhim, tregti, shërbime dhe ndërtim ALFA TRANS CORP DOOEL Strumicë	Strumicë	5,415	24,793
Shoqëria për tregti dhe shërbime VIN STAR CLUB DOOEL në Petralinca, Bosilovë	Petralinca	24,065	23,487
Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit STARBET DOO Shkup	Shkup - Butel	813	21,230
Shoqëria tregtare MINT CLUB INTERNATIONAL LLC Gjevgjeli	Gjevgjeli	22,081	11,034
Shoqëria për tregti, hotelieri dhe shërbime STEFANATOR DOOEL import-eksport Veles	Veles	0	5,029
Shoqëria për tregti dhe shërbime ADMIRAL CASINO MK DOO Shkup	Shkup - Qendër	18	465
Shoqëria për shitje dhe shërbime GRAND SLOT DOO f. Kadino, Ilinden	Kadina	0	163
Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime LORI CAR-TRITE ANGELI DOOEL f. Koleshina, Novosellë	Koleshina	33	33
Shoqëria tregtare për prodhim, tregti dhe shërbime JOVANAS DOO import-eksport Ohër	Ohër	0	0
Shoqëria për lojëra fati dhe shërbime GEMEX BET DOOEL Bogdanci	Bogdanci	0	0
Ndërmarrja tregtare MONOPOLI CONSULTING SH.PK Gjevgjeli	Gjevgjeli	12,198	0
Shoqëria për prodhim, tregtim dhe shërbime LORI KAR JUNIOR DOOEL import-eksport në f. Koleshina, Novosellë	Koleshina	0	0
Shoqëria për teknologji informative SWISS-SYSTEMS DOOEL Gostivar	Gostivar	488	0
Shoqëria për lojëra të fatit, tregti, konsulencë, ndërmjetësim dhe shërbime LOTUS TECHNOLOGIES DOOEL Shkup	Shkup - Gazi Babë	0	0
Shoqëria për baste sportive dhe lojëra të fatit, tregti dhe shërbime AHHBET DOO import-eksporti Kërçovë	Kërçovë	0	0



Instituti për Demokraci dhe Analiza Ekonomike – IDEA është “think tank” i krijuar në mars të vitit 2023 në Shkup, me mbështetjen e European Endowment for Democracy.

Në esencë, ne besojmë se forca e demokracisë tonë dhe cilësia e politikave ekonomike janë ngushtë të lidhura me angazhimin dhe pjesëmarrjen tonë demokratike. Ky besim i palëkundur ushqen qëllimin tonë, si ekip i përkushtuar për të kontribuar në rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të demokracisë dhe politikave ekonomike në Maqedoninë e Veriut. Ne e përfytyrojmë Maqedoninë e Veriut si një shtet anëtar progresiv, liberal dhe rezilient i Bashkimit Evropian i cili është i ndërtuar mbi gjithëpërfshirje, inovacion dhe qëndrueshmëri. Ne jemi këtu për ta avancuar demokracinë dhe për të nxitur zhvillimin!

www.idea.org.mk

Tetovska 33/2/7 , Skopje, Republic of Macedonia

+389 70 985 729

